



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 94, Datë 15.03.2023

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 45, DATË 20.02.2023, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 280, SERIA PV15K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “KOXHERRI ENERGJI” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1064/3 prot., datë 13.03.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 45, datë 20.02.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 280, Seria PV15K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k., për arsye të mosshlyerjes në afat të pagesës rregullatore për vitin 2022 të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe po ashtu nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën nr. 958 prot., datë 27.02.2022, shoqëria është njoftuar për vendimin e bordit të ERE-s nr. 45/2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 02.03.2023.
- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijëni të subjektit, rezulton se shoqëria “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k. i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 9, gërma “a” të *Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, parashikohet se, *Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.*
- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se, *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.* Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k.
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës të prapambetur, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i është vendosur masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës, dhe duke qenë se objekti për të cilin filloi procedura për heqjen e licencës së të licencuarit nuk ekziston më, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të bordit të ERE-s nr. 45/2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 45, datë 20.02.2023, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 280, Seria PV15K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k.”.
2. Të shfuqizojë vendimin e bordit të ERE-s nr. 45, datë 20.02.2023.
3. Grupi i Punës të njoftojë shoqërinë “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**